



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:018427

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465394

P.nr.2023:0184223

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm Penal, gjyqtari i vetë gjykues Adem Shabani, me procesmbajtësen Zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në lëndën penale kundër të pandehurit L.S., me vendbanim në rrugën “ ... ” në Ferizaj, për shkak të Veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm Penal, me numër PP/II.nr.1743/2022 të datës 20.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, dhe i pandehurit L.S., me datën 06.03.2024, mori dhe shpalli, kurse me datë 18.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

- **L.S.**, nga Ferizaji, rr”...”, i lindur me ..., nga i ati Z. dhe e ëma R. e gjinisë L., me profesion autolimar, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ..., gjendet në liri,-

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

- Me 26 Tetor 2022, rreth orës 16:00, në rrugën “...”, në Ferizaj, ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtën që ka menduar se i takon në vend se t’i drejtohet organit kompetent, ashtu që derisa e dëmtuara B.Q. e ka pas dorë telefonin nga mbrapa i merr telefonin dhe largohet pasiqë e dëmtuara i kishte mbetur borgj 170.00 € lidhur me rregullimin e veturës,

- **me të cilën kreu veprën penale vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së,**

Gjykata në kuptim të dispozitës së neneve 2, 3 paragraf 1, nenit 4, 6, 7, 17, nenit 38, nenit 39 paragraf. 1 nën paragraf 1.1 dhe 1.2, 69, 70, 71,77, 81, 82, të KPRK-së, dhe neneve 358, 359, 360, 361, 364, 365, 449, 462, 498, 499 të KPP-së, e

G J Y K O N

-Të pandehurit **L.S.**, i shqipton VËREJTJE GJYQËSORE, ku të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penale.

- Obligohet i pandehuri, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) Euro, si dhe në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 30.€uro (tredhjet euro), e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

- E dëmtuara: B.Q., nga Ferizaji, rruga ” ...”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike nuk është është udhëzohet në kontest civil, pasi që në shqyrtimin fillestar ka hequr dorë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.1743/2022 të datës 20.01.2023, kundër të pandehurit L.S., me vendbanim në rrugën “ ... ” në Ferizaj, për shkak të Veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së

Gjykata me datën 09.03.2023 në këtë lëndë penale ka caktuar dhe ka mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe në bazë të nenit 241 par. 1, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar në tersi udhëzimet nga ana e gjyqtarit, mbrojtjen do ta paraqes vetë.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat pranimit të fajësisë por i pandehuri L.S., nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 240 paragrafi 7 dhe neneve 243 dhe 244 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) e ka udhëzuar të pandehurin L.S.,

se në afatin prej 30 ditësh mundë të paraqet prova për kundërshtimin e aktakuzës apo kërkesë për hudhjen e aktakuzë , por i pandehuri nuk ka parashtrua kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata me datën 06.03.2024, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu dhe të pandehurit L.S. kurse e dëmtuara B.Q., është ftuar me ftes të rregullt ku shpërndarësi i ftesave në fletë dërgesën për dorëzim personale me dt.04.03.204, është njoftuar nga fqinjët se B.Q. gjendet jashtë shtetit, ku edhe përmes numrit të telefonit të saj që gjendet në shkresat e lëndës gjykata ka marrë veprime që të kontaktoj me te por nuk ka pasur qasje.

Edhe në shqyrtimin gjyqësor e ka ftuar të pandehurin përsëri të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 319 parag.2.1,2.2 2.3 dhe 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

Prokurori i shtetit edhe në shqyrtimin gjyqësor të pandehurit i ka lexuar aktakuzën të pandehurit dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën për të cilën është akuzuar dhe të njëjtit përsëri i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilën akuzohen.

I pandehuri L.S., në shqyrtimin gjyqësor lidhur me veprën penale që akuzohet deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohem jam i penduar është hera e parë që deshëm me ligjin nuk kam qen në dijeni se këto veprime që i kam kryer janë vepra penale pasi qe e dëmtuara nuk gjendet ne Kosovë, vëllai i saj me ka premtuar se do te ma kthej borxhin, andaj i propozoj gjykatës qe me rastin e shqiptimit te dënimit te merr parasysht te gjitha rrethanat lehtësuese dhe është hera e par qe ndeshem me ligjin se dhe me te dëmtuar skam kurrfarë problem.

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në nenin 322 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shtetit , ku prokurori i shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqë i njëjti pranim është i bazuar me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i njëjti e bënë vullnetarisht.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas marrjes së mendimit të palëve, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par.1 pika 1.1, 1.2 1.3 , 1.4, 1.5 dhe 1.6 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 322 par 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje

penale nuk është zbatuar procedura e provave, por shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Albert Zejnllahu, ka deklaruar pasi që i pandehuri e pranon fajësinë ë filli të shqyrtimit gjyqësor atëherë gjendja faktike është vërtetuar ashtu siç përshkruhet ne aktin akuzues, kjo ka mbështetje edhe ne provat që gjenden ne shkresat e lendes , pranimi i fajësisë u be vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimi te fajësisë, kërkoj nga gjykata që te njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj Konform ligjit, sa i për këtë llojit dhe lartësisë se dënimit gjykata ti këtë parasysh te gjitha rrethanat rendues dhe lehtësuese ashtu që me sanksionin e shqiptuar te arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri L.S., në fjalën përfundimtare pranon se mbetem pran deklarimit që te thash ne fillim dhe i premtoj gjykatës se me te dëmtuarën nuk kam diçka keq se me nuk jam takuar me te jam i martuar baba i një fëmije mbajtës i familjes andaj i kërkoj gjykatës për rastin për te cilin akuzohem ti merr parasysh te gjitha rrethanat lehtësues.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale si raporti i oficerit, deklarata e të dëmtuarës, deklarata e të pandehurit, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara e përkohësisht si dhe shkresat tjera të lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në fillim të shqyrtimit kryesor i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin për veprën penale që e ka kryer, premtimin se kundër të dëmtuarës nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, dhe me te nuk ka asgjë të keqe, Gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe është e bindur se edhe me shqiptimin e Vërejtjes gjyqësore do të arrihet qëllimi i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja

e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimin për udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marrë bazë të nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marr në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.6 të të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPP-së.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr 2023:018428 me datë 18.03.2024

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari,

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.